

**Raport mbi Monitorimin e Realizmit të
Planeve të Integritetit të Njësive të Vetëqeverisjes
Vendore për Vitin 2024**

Table of Contents

I. Hyrje	3
II. Metodologjia e vlerësimit	4
III. Monitorimi i zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit	9
IV. Vlerësim i impaktit të zbatueshmërisë së masave të Planit të Integritetit. Error! Bookmark not defined.1	
IV. Krahasimi mes shkallës së zbatueshmërisë dhe impaktit të Planeve të Integritetit.....	9
V. Konkluzione dhe Rekomandime.....	155
Shtojca.....	Error! Bookmark not defined.7

Lista e Figurave

Figura 1: Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktivitetëve sipas Planeve të Integritetit,	10
Figura 2: Objektivi I. Forcimi i sistemit të integritetit në bashki duke siguruar një kuadër të brendshëm rregullator pro-integritet;.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 3: Objektivi II - Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare.....	Error! Bookmark not defined.2
Figura 4: Objektivi III: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;.....	Error! Bookmark not defined.3
Figura 5: Shkalla e realizimit kundrejt vlerësimit të ndikimit të masave në integritet	Error! Bookmark not defined.4

Lista e Tabelave

Tabela 1: Indikatorë të vlerësimit të forcimit të sistemit të integritetit.....	6
Tabela 2: Indikatorë të vlerësimit të mirë-menaxhimit dhe forcimit të integritetit	7
Tabela 3: Indikatorë të vlerësimit të transparencës në forcimin e integritetit.....	8
Tabela 4: Shkalla e vlerësimit të impaktit sipas objektivave të Planit të Integritetit.....	9

I. Hyrje

Korrupsioni është një sfidë e vazhdueshme për qeverisjen demokratike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike. Si një fenomen kompleks dhe dinamik, ai përshtatet shpejt ndaj zhvillimeve ligjore, teknologjike dhe organizative. Përballë kësaj dinamike, lufta kundër korrupsionit kërkon një qasje të vazhdueshme, të qëndrueshme dhe të pakompromis. Kjo nënkupton forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, sidomos në sektorët më të ekspozuar ndaj rrezikut.

Në nivelin vendor, nevoja për të forcuar në mënyrë të vazhdueshme sistemet e menaxhimit të integritetit, në kuadër të thellimit të procesit të decentralizimit, është evidente. Ky proces i shërben forcimit të llogaridhënies, duke e afruar qeverisjen me qytetarët. Megjithatë, në fushën e shërbimeve publike, për shkak të rritjes së kontakteve ndërmjet zyrtarëve vendorë dhe qytetarëve, procesi i decentralizimit mund të shpërndajë edhe risqet e integritetit, duke e bërë të vështirë eliminimin e plotë të tyre. Kjo bën të domosdoshme ndërmarrjen e masave proaktive për menaxhimin e këtyre risqeve. Në këtë drejtim, hartimi i Planeve të Integritetit dhe i Planeve përkatëse të Veprimit nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV), si dhe monitorimi i zbatimit të tyre, ofrojnë kuadrin konceptual për politikën dhe masat që synojnë parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë.

Zbatimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore, është konkretizuar përmes koordinimit dhe zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023, e cila vijon me Strategjinë e re 2024-2030 dhe Planin e Veprimit 2024-2026, të miratuara me Vendimin nr.859, datë 26.12.2024.

Menaxhimi i riskut të integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore përfaqëson një proces të rëndësishëm, i cili mbështetet në Qëllimin e parë të Politikës: Parandalimi i korrupsionit dhe konkretizohet në Objektivin Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces kontribuon gjithashtu në realizimin e Qëllimit Politik 5 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 (SNDQV): “Forcimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor, Objektivi Specifik 5.2: “Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin”, miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023. Menaxhimi i riskut të integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore është gjithashtu në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, ku ndër rekomandimet e dhëna theksohet zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit në nivel vendor zbatohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, që përfshin të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Hapi i parë i këtij procesi është hartimi i Planit të Integritetit për njësinë vendore, i detajuar edhe me një Plan Veprimi trevjeçar. Monitorimi dhe raportimi i këtij plani përbëjnë etapën tjetër të menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi zhvillohet periodikisht (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga punonjësit dhe drejtuesit e bashkisë, për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata mbajnë.

Menaxhimi i integritetit institucional dhe monitorimi si hallkë përbërëse e këtij procesi, synojnë të ndihmojnë politikbërësit, administratat vendore dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për të përmirësuar kontrollin ndaj korrupsionit në komunitetet e tyre. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Planit të Integritetit, si një fazë e rëndësishme e ciklit të menaxhimit të risqeve të integritetit, i mundëson bashkive të identifikojnë potencialin për përmirësim në fusha specifike të veprimtarisë së tyre. Një analizë rigorozë e këtyre fushave ndihmon në zhvillimin e strategjive të bazuara në evidenca dhe në ndërmarjen e masave konkrete për të prandaluar ose zvogëluar korrupsionin, duke garantuar qeverisje të mirë dhe efikase.

II. Metodologjia e Vlerësimit

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar procesin e monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit në nivel bashkie për vitin 2024.. Për realizimin e këtij procesi, AMVV ka bashkëpunuar dhe ka koordinuar punën me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore që kanë miratuar një Plan Integriteti. Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Planit të Veprimit të Planit të Integritetit të bashkive është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 553, datë 30.09.2021 “*Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet qendrore*”.

Raporti i monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2024, përmban një analizë të përgjithshme për realizimin e masave/aktiviteteve të parashikuara për secilën fushë të planifikuar në Planin e Veprimit për periudhën e kërkuar. Ky raport realizimi jep të dhëna për statusin e zbatimit të hartimit dhe plotësimit të kuadrit të brendshëm rregullator në fushat e etikës dhe integritetit, menaxhimit të burimeve njerëzore në mënyrë të qëndrueshme dhe profesionale, transparencës dhe menaxhimit të riskut të integritetit në fusha të vecanta të përgjegjësisë.

Në këtë kuadër, janë hartuar **Raportet e Monitorimit të zbatimit të Planeve të Veprimit të Planeve të Integritetit** për bashkitë: Berat, Bulqizë, Durrës, Has, Himarë, Kavajë, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnje, Maliq, Patos, Pogradec, Pukë, Roskovec, Shijak dhe Tiranë. Këto raporte janë bashkëlidhur këtij dokumenti dhe janë gjithashtu të publikuara në faqet zyrtare web të bashkive përkatëse, si dhe në faqen e AMVV-së. Të dhënat për hartimin e këtij raporti janë mbledhur dhe raportuar nga Koordinatorët e Integritetit të Njësisë të Vetëqeverisjeve Vendore. Monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

Kjo metodologji bazohet në analizën e Planeve të Veprimit të Integritetit dhe përfshin raportimin për çdo masë apo aktivitet të parashikuar, duke vlerësuar zbatimin e tyre përmes të dhënave të raportuara në nivel vendor.

Sa më sipër, ky raport analizon të dhënat si më poshtë:

- Shkallën e realizimit të objektivave, nëpërmjet analizës së raportimit të masave dhe aktiviteteve krahasimisht për të gjitha Bashkitë;

- Analizën e procesit të zbatimit të masave/aktiviteteve, duke identifikuar ndikimin e tyre në forcimin e integritetit të institucionit;
- Paraqitjen e treguesve të ndikimit të këtyre masave në arritjen e objektivave të planit të integritetit;

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve klasifikohet me vlerat si më poshtë:

- E realizuar: Masa/aktivitete që janë përbushur plotësisht
- Pjesërisht e realizuar/në proces: Masa/aktivitete që janë përbushur pjesërisht ose vijojnë të jenë në proces
- E porealizuar; Masa/aktivitete që nuk kanë regjistruar progres gjatë periudhës raportuese ose për të cilat nuk është dhënë raportim nga struktura përgjegjëse.

Në përfundim të analizës, shkalla e zbatimit të Planit të Integritetit do të vlerësohet përmes një treguesi të përgjithshëm, i cili përmbledh vlerësimin sipas objektivave, duke u dhënë peshë të barabartë secilit objektiv. Në këtë mënyrë, treguesi i vlerësimit të zbatueshmërisë së Planit të Integritetit në bashki varion nga 0% deri në 100%, duke reflektuar nivelin e zbatimit. Nga ana tjetër, duke qenë se monitorimi i kryer është cilësor dhe jo sasior, ndarja në nivele vlerësimi e Planeve të Integritetit nuk është matematikisht uniforme.

Rezultatet e raporteve të monitorimit përmbledhen në tabelën e mëposhtme, ku janë pasqyruar: numri total i masave, numri i masave të realizuara, numri i masave në proces dhe numri i masave të porealizuara për çdo bashki. Gjithashtu, për secilën nga njësitë vendore është kryer edhe përlllogaritja në përqindje e masave të realizuara, në proces dhe të porealizuara:

% e masave të realizuara = numri i masave të realizuara / nr total i masave të planifikuara për vitin 2024 për bashkinë

% e masave në proces = numri i masave në proces / nr total i masave të planifikuara për vitin 2024 për bashkinë

% e masave të porealizuara = numri i masave të porealizuara / nr total i masave të planifikuara për vitin 2024 për bashkinë

Shkalla e realizimit të Planeve të Integritetit për 17 bashkitë vlerësohet mbi totalin e masave si përqindje e masave të realizuara kundrejt masave totale.

% e masave të realizuara për 17 bashkitë e monitoruara = shuma e numrit të masave të realizuara për të gjitha bashkitë/ shuma e masave të planifikuara për vitin 2024 për të gjitha bashkitë.

Indikatorët e performancës në një Plan Integritetit në qeverisjen vendore varen nga qëllimet dhe objektivat specifike të përfshira në planin përkatës. Në kontekstin e këtij raporti, ato mund të përmbledhen në tre objektiva kryesorë:

- *Frocimi i sistemit të integritetit në bashki, përmes sigurimit të një kuadri të brendshëm rregullator me qasje pro-integriteti;*
- *Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare;*
- *Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;*

Raporti i moitorimit përfshin gjithashtu një analizë të ndikimit të Planit të Integritetit në përmbushjen e objektivave. Indikatorët e zhvilluar për të matur nivelin e arritjes së objektivit të parë – forcimi i integritetit – përfshijnë aspekte që lidhen me përmirësimin e kuadrit rregullator dhe krijimin e strukturave institucionale në funksion të integritetit.

Konkretisht, indikatorët vlerësojnë nëse bashkitë kanë hartuar akte të brendshme (rregullore, udhëzime, procedura) për menaxhimin e situatave me risk për krijimin e rasteve korruptive, konfliktit të interesit apo sjelljeve joetike. Bashkitë vlerësohen pozitivisht në rast se kanë konsoliduar kuadrin rregullator, kanë ngritur struktura të dedikuara dhe kanë ndërtuar një qasje strategjike për parandalimin e konfliktit të interesit, menaxhimin e risqeve dhe forcimin e integritetit institucional. (shih Tabelën 1)

Tabela 1: Indikatorë të vlerësimit të forcimit të sistemit të integritetit

Objektivi I. Forcimi i sistemit të integritetit në bashki, duke përmes sigurimit të një siguruar një kuadër kuadri të brendshëm rregullator me qasje pro-integriteti	Pikëzimi
Bashkia ka Kod Sjellje/ Etike të miratuar dhe publikuar (ose kapitull mbi etikën në rregulloren e brendshme)	5
Bashkia ka rregullore (bazuar në Nenin 46 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005) “Për parandalimin e konfliktit të interesave.	5
Në aktet e brendshme të bashkisë, ka dispozita që rregullojnë marrjen dhe raportimin e dhuratave për punonjësit e bashkisë dhe këshillit bashkiak.	5
Bashkia ka rregullore të brendshme për procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit.	5
Bashkia ka ngritur një strukturë të brendshme (grup pune/koordinator) për zbatimin e Planit të Integritetit.	5
Bashkia ka trajtuar raste të masave që kanë ardhur si rezultat i sinjalizuesve;	5
Plani i integritetit për institucionin bazohet në analizën e risqeve ndaj integritetit dhe harton masa për menaxhimin e tyre;	5
Bashkia ka ngritur njësinë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet për veprime ose praktika të dyshuara korupsioni;	5
Bashkia ka hartuar raport monitorimi të zbatimit të Planit të Integritetit;	5

Për të vlerësuar rritjen e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki, përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare, u identifikuan një sërë indikatorësh që tregojnë nëse bashkia ka ndërtuar sisteme monitorimi në funksion të këtij qëllimi. Këta indikatorë vlerësojnë aspektet kryesore të mirë-menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare, të shërbimeve publike dhe të integritetit institucional. Ndër indikatorët e përdorur përfshihen: monitorimi i zbatimit të planit të integritetit, përdorimi i instrumenteve të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare, menaxhimi i pronave publike, menaxhimi i shërbimeve publike të ofruara, si dhe trajtimi i ankesave dhe kënaqësisë së qytetarëve. (shih Tabelën 2)

Tabela 2: Indikatorë të vlerësimit të mirë-menaxhimit dhe forcimit të integritetit

Objektivi II: Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare	Pikëzimi
Bashkia ka përshkrime të punës për çdo pozicion në shërbimin civil.	5
Bashkia ka një sistem të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë	5
Bashkia ka një plan/program për kualifikimin dhe trajnimin e administratës të bazuar në nevojat e identifikuara të institucionit të bazuara në vlerësimin e performancës së stafit;	5
Bashkia dhe institucionet në varësi të saj nuk kanë rritur detyrimet financiare të papaguara ndaj enteve kontraktore për punë, mallra dhe shërbime gjatë vitit të raportimit;	5
Vlera e raportit mes të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të realizuara me ato të planifikuara është > xx%;	5
Raportin vjetor i shpenzimeve buxhetore fakt/shpenzimeve buxhetore plan është > 80%	5
Gjatë kontrollit të fundit të KLSH nuk janë raportuar dëme financiare;	5
Bashkia ka shërbime publike me sistemin e treguesve të performancës (përfshirë ato gjinor dhe aksesin e grupeve të cënueshme) si mekanizëm monitorimi dhe vlerësimi;	5
Bashkia ka strukturë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimeve publike të ofruara nga pushteti vendor;	5
Bashkia raporton monitorimet/kontrollet e bëra për zbatimin e kontratave të punëve publike;	5
Bashkia një strukturë të veçantë dhe strategji për menaxhimin e pronave dhe asetëve të saj	5
Bashkia ka një bazë të integruar të dhënash (databazë) për pasuritë e paluajtshme përfshirë, por pa u kufizuar, sistemin e informacionit GIS dhe sistemin e menaxhimit financiar	5
Bashkia ka një plan të përgjithshëm vendor të miratuar	5
Bashkia ka plan strategjik për zhvillimin ekonomik vendor.	5
Ekziston një sistem i monitorimit të vazhdueshëm të kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet e ofruara nga bashkia;	5

Një grup indikatorësh monitorimi kanë vlerësuar ndikimin e planeve të integritetit në forcimin e transparencës institucionale dhe të mekanizmave të llogaridhënies, duke kontribuar në reduktimin e hapësirave për keqpërdorimin e pushtetit dhe ndërmarrjen e veprimeve joetike apo korruptive. Ky grup indikatorësh përfshin aspekte që lidhen me transparencën rregullatore, transparencën në procesin e hartimit të politikave vendore – veçanërisht atyre të identifikuara si prioritet strategjike dhe të zhvillimit. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e veçantë të procedurave të prokurimit,

rekrutimit dhe komunikimit me publikun, indikatorët përfshijnë publikimin e planit të prokurimeve, planit të pranimeve në shërbimin civil, raporteve të auditimit si dhe përgjigjet e dhëna ndaj kërkesave të adresuara nga publiku. (shih Tabelën 3)

Tabela 3: Indikatorë të vlerësimit të transparencës në forcimin e integritetit

Objektivi III: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;	Pikëzimi
Bashkia ka Program Transparencës të plotësuar dhe përditësuar;	5
Bashkia ka publikuar në faqen zyrtare Planin e Integritetit	5
Bashkia ka publikuar planin e zhvillimit strategjik	5
PBA (Programit Buxhetor Afatmesëm) është konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit;	5
Bashkia ka publikuar në faqen zyrtare “Raportin Vjetor të Monitorimit të buxhetit	5
Bashkia ka publikuar raportin më të fundit të auditit të brendshëm në faqen zyrtare internetit (web) të bashkisë;	5
Bashkia ka plan vjetor, të miratuar dhe të publikuar për pranimin në shërbimin civil.	5
Bashkia ka shpallur vendet vakante për periudhën që po raporton;	5
Bashkia ka zhvilluar seanca këshillimi për procedurat e tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave të bashkisë të tretëve;	5
Bashkia ka publikuar në faqen zyrtare të internetit kontaktet për koordinatorin e informimit;	5
Bashkia ka publikuar rregulloren e brendshme të miratuar;	5
Numri mesatar i ditëve për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion është më i vogël se 10 ditë pune;	5
Bashkia vë në dispozicion të publikut një faqe dinamike interneti ku ofrohet informacion i përditësuar dhe publiku informohet në kohë.	5
Është i publikuar regjistri i parashikimeve të prokurimit publik në faqen zyrtare në internet (faqja web) të Bashkisë.	5
Është i publikuar në faqen zyrtare (website) të Bashkisë regjistri i realizimit të prokurimeve.	5

Indikatorët e realizuar (të plotësuar nga bashkia) vlerësohen me nga pesë (5) pikë secili dhe kontribuojnë në matjen e ndikimit të masave të planit të integritetit në arritjen e objektivave përkatëse. Vlerësimi i përgjithshëm sipas indikatorëve mund të arrijë një maksimum prej 200 pikësh, ndërkohë që distanca e një institucioni nga ky vlerësim optimal reflekton edhe shkallën e ndikimit të planit të integritetit si një mjet parandalues në luftën kundër korrupsionit.

Indeksi i përgjithshëm i ndikimit të planit të integritetit është ndërtuar si shuma totale e pikëve të akorduara për secilin indikator. Indikatorët janë të konceptuar si matës të thjeshtë, të formuluar në formën e deklaratave, të cilat vlerësohen pozitivisht (me pikë) në rast se janë të mbështetura në të dhënat dhe dokumentacionin përkatës të bashkisë; përndryshe vlerësohen me zero. Përmes masave

të zbatuara në kuadër të planeve të integritetit, bashkitë duhet të kenë përmirësuar transparencën, praktikat e menaxhimit dhe kuadrin rregullator në funksion të forcimit të integritetit institucional.

Tabela 4: Shkalla e vlerësimit të impaktit sipas objektivave të planit të inntegritetit bazuar në vlersimin sipas indeksit të integritetit:

Objektivat e Planeve të Integritetit	Vlerësimi
Objektivi I. Focimi i sistemit të integritetit në bashki, duke përmes sigurimit të një siguruar një kuadër kuadri të brendshëm rregullator me qasje pro-integriteti	50
Objektivi II: Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare	75
Objektivi III: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësive dhe llogaridhënies publike të bashkisë;	75

III. Monitorimi i zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit

Monitorimi synon të identifikojë dhe të vërë në funksion mekanizmat e nevojshëm për minimizimin e faktorëve që lidhen me shkaqe, presione, raste apo mundësi të krijuara, të cilat shërbejnë si bazë për shfaqjen e fenomeneve korruptive. Në këtë mënyrë, ai kontribuon në menaxhimin efektiv të fushave me risk dhe në sigurimin e ofrimit të shërbimeve publike cilësore, të paanshme dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve.


Në këtë kontekst, ky dokument ka shërbyer si një mjet gjithëpërfshirës parandalues ndaj korrupsionit, që synon promovimin dhe forcimin e integritetit institucional, përmes nxitjes së integritetit individual, rritjes së profesionalizmit, respektimit të etikës si dhe zbatimit të vlerave morale dhe standardeve profesionale.

Në vijim të përpjekjeve për të konsoliduar integritetin institucional dhe për të mbrojtur institucionet nga cënimi i tij, gjatë periudhës janar – dhjetor 2024 janë shënuar disa arritje të rëndësishme. Nga llogaritja e shkallës së zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit rezulton se, në nivel kombëtar, planet e veprimit janë realizuar mesatarisht në masën 59%.

Gjatë vitit 2024, bashkitë kanë treguar angazhim dhe përkushtim në zbatimin e masave të përfshira në planet e integritetit, duke kontribuar në zvogëlimin e risqeve që lidhen me veprime joetike apo korruptive. Shkalla e përgjithshme e realizimit të planeve rezulton në një mesatare prej 59.6%.

Bashkitë që raportojnë nivelin më të lartë të zbatimit të planeve janë Roskovec, Himarë, Berat, Tiranë, Lushnje, Lezhë, Pogradec, Patos dhe Has. Ndërkohë, bashkitë si Maliq, Pukë, Kukës dhe Kavajë, kanë shënuar një progres më të ngadaltë në numrin e masave të realizuara. Megjithatë, të dhënat tregojnë se këto bashki kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimit të transparencës, edhe pse mbetet ende punë për t'u bërë në këto drejtime.

Figura 1: Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktiviteteteve sipas planeve të integritetit, 2024




Nga monitorimi i realizimit të masave dhe aktiviteteteve të ndërmarra nga bashkitë evidentohet një përmirësim i dukshëm i kuadrit rregullator në fushën e etikës dhe integritetit. Kjo përfshin miratimin e kodeve të sjelljes, përmirësimin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe plotësimin dhe publikimin e programeve të transparencës në faqet zyrtare të NJVV-ve. Gjithashtu, zbatimi i Planeve të Integritetit ka sjellë efekte pozitive në procedurat e prokurimeve publike, llogaridhënien dhe forcimin e rolit të audituesve të brendshëm, qartësimin e detyrave të personelit, si dhe përmirësimin në menaxhimin financiar dhe transparencës me komunitetin, veçanërisht në treguesit financiarë. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësive të sinjalizuesve, si dhe në krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave për shmangien e konfliktit të interesit, për dhuratat, si dhe për administrimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve. Monitorimi i zbatimit të masave specifike të përcaktuara në Planet e Veprimit përbën një mekanizëm të rëndësishëm për vlerësimin e impaktit të këtyre masave. Zbatimi i masave me efektivitet është një tregues pozitiv i përparimeve në parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e integritetit në nivel vendor.

IV. Vlerësimi i shkallës së zbatueshmërisë së masave të Planit të Integritetit sipas objektivave;

Impakti i zbatimit të masave të përfshira në Planet e Integritetit në nivel vendor lidhet drejtpërdrejt me nivelin e realizimit të objektivave të planifikuara. Pavarësisht mënyrës së formulimit të këtyre objektivave nga secila bashki, në thelb Planet e Integritetit kanë synuar të forcojnë kuadrin rregullator me funksion parandalues ndaj korrupsionit dhe të nxisin krijimin e një kulture organizative të orientuar drejt integritetit në tri fusha kryesore: së pari, në përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit të brendshëm rregullator për çështje të veçanta që lidhen me integritetin; së dyti, në fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet rekrutimit të personelit të kualifikuar dhe ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për t'u bërë rezistentë ndaj shkeljeve të mundshme të integritetit; dhe së treti, në rritjen dhe konsolidimin e transparencës institucionale, në përputhje me fushat përkatëse të përgjegjësisë.

Në vijim, paraqitet një përmbledhje sipas fushave kryesore të ndërhyrjes dhe impaktit të vërejtur gjatë zbatimit të planeve në nivel vendor:

Figura 2: Objektivi I. Frocimi i sistemit të integritetit në bashki, duke përmes sigurimit të një kuadri të brendshëm rregullator me qasje pro-integriteti;




Bashkitë që kanë arritur të ndryshojnë aspekte të kuadrit rregullator dhe të forcojnë kulturën pro-integritet, janë bashkitë Lezhë, Durrës, Berat, Tiranë, Patos, Shijak dhe Has. Indeksi i vlerësimit të impaktit për këto bashki rezulton i lartë. Ndërkohë, bashkitë Kavajë, Librazhd, Kukës dhe

Bulqizë duhet të intensifikojnë përpjekjet në forcimin e kulturës pro-integritet dhe në përmirësimin e mekanizmave rregullatorë përkatës (shih Figurën 2).

Në shumicën e bashkive, vihet re një përmirësim i dukshëm i rregulloreve të brendshme, kodeve të etikës dhe akteve të tjera të orientuara drejt minimizimit të sjelljeve joetike apo të dëmshme. Këto përmirësime kanë kontribuar ndjeshëm në ndërtimin e një kulture institucionale pro-integritet, ku etika konsiderohet si një komponent thelbësor i procesit vendimmarrës.

Gjithashtu, janë përmirësuar mekanizmat e arkivimit dhe të auditimit të brendshëm, ndërkohë që janë krijuar dhe funksionalizuar instrumente të posaçme për sinjalizimin e shkeljeve dhe për mbrojtjen e sinjalizuesve. Si rezultat, është mundësuar identifikimi më i hershëm i problematikave dhe janë ndërmarrë veprime parandaluese më efektive ndaj rreziqeve që çenojnë integritetin institucional.

Figura 3: Objektivii II - Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare;




Ndikimi i masave të planit të integritetit në menaxhimin me integritet të burimeve njerëzore dhe financiare ka nxjerrë në pah një lidhje të qartë midis forcimit të kulturës organizative pro-integritet

dhe përmirësimit të mirë-menaxhimit institucional. Edhe pse kjo lidhje nuk është gjithmonë e drejtpërdrejtë, rezultatet tregojnë se promovimi i integritetit në strukturat organizative përforcon ndjeshëm kapacitetin për menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent.

Të gjitha bashkitë kanë nevojë për përforcimin e mëtejshëm të integritetit në menaxhimin publik, por bashkitë e Durrësit, Hasit, Patosit dhe Maliqit evidentohen si njësi që duhet të ndërmarrin përmirësime të konsiderueshme në këtë drejtim (shih Figurën 3).

Në përgjithësi, bashkitë kanë ndërmarrë masa të rëndësishme në drejtim të trajnimit të stafit, vlerësimit të performancës, përmirësimit të përshkrimeve të vendeve të punës, si dhe rritjes së transparencës në proceset e rekrutimit. Vërehet një tendencë pozitive drejt vlerësimit të meritokracisë dhe profesionalizmit, veçanërisht në sektorët me risk më të lartë siç janë menaxhimi financiar dhe ofrimi i shërbimeve publike.

Figura 4: Objektivi III: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;



Ndër aspektet më të rëndësishme që ndikohen nga zbatueshmëria e Planeve të Integritetit janë transparenca dhe llogaridhënia. Zbatimi i këtyre planeve ka ndikuar pozitivisht në forcimin e këtyre dy elementëve në pothuajse të gjitha bashkitë, megjithatë ndikimi më i lartë është evidentuar në bashkitë Tiranës, Pogradecit, Roskovecit dhe Lushnjës. Në përgjithësi bashkitë e vogla, për shkak të kufizimeve në burime teknike (financiare dhe IT), kanë shkallë më të ulët të impaktit të zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies.


Megjithatë, shumica e bashkive kanë shënuar përparim të ndjeshëm në transparencën proaktive, kryesisht përmes përditësimit të rregullt të faqeve zyrtare, publikimit të dokumenteve strategjike, informacionit financiar dhe akteve rregullatore. Transparenca është cilësuar në disa raste si objektivi më i suksesshëm, duke reflektuar edhe një prioritet të qartë të bashkive për forcimin e llogaridhënies dhe përfshirjen e publikut. Njëkohësisht, nëpërmjet përfshirjes së komunitetit në konsultime dhe raportimeve të hapura, është forcuar ndjeshëm perceptimi i integritetit dhe përgjegjshmërisë nga qytetarët.

V.Krahasimi mes shkallës së zbatueshmërisë dhe impaktit të Planeve të Integritetit

Është realizuar krahasimi i performancës së bashkive në zbatimin e masave të Planeve të Integritetit me indeksin që vlerëson ndikimin e këtyre masave në arritjen e objektivave. Rezultatet tregojnë se bashkitë e Beratit, Lezhës dhe Himarës, pavarësisht se raportojnë një shkallë mesatare të zbatueshmërisë së planeve të integritetit, nuk kanë arritur një përmirësim të dukshëm në transparencë, kuadrin rregullator institucional apo në praktikën e menaxhimit publik. Për rrjedhojë, indeksi i vlerësimit të ndikimit të masave të zbatuara në këto bashki mbetet i ulët.

Në të kundërt, një ndikim i lartë i masave të planeve të integritetit është evidentuar në bashkitë e Roskovecit, Himarës, Pogradecit, Lushnjës, Librazhdit, Tiranë dhe Patosit, të ndjekura nga disa bashki më të vogla si Shijaku, Puka dhe të tjera. Këto bashki kanë arritur të përkthejnë masat e zbatuara në përmirësime konkrete dhe të qëndrueshme në transparencë, forcimin e kuadrin rregullator dhe avancimin e praktikave të integritetit në menaxhimin publik.

Figura 4: Shkalla e realizimit kundrejt vlerësimit të ndikimit të masave në integritet



Vlerësimi i korelacionit mes shkallës së zbatueshmërisë dhe indeksit të impaktit të Planit të Integritetit tregon se ka një përmirësim me 15 pikë përqindje në aspekte të integritetit institucional dhe rritje me 1 pikë përqindje e shkallës së zbatueshmërisë së plotë të Planit të Integritetit. Lidhja pozitive mes zbatueshmërisë së masave të Planit të Integritetit dhe impaktit në forcimin e kulturës pro-integritet të institucioneve të pushtetit vendor, konfirmon edhe njëherë se pëpjekjet për të marrë masa parandaluese anti-korrupsion do të sjellin ndryshime pozitive.

VI. Konkluzione dhe Rekomandime:

Ky raport monitorimi është hartuar në përputhje me metodologjinë për hartimin e raportit të monitorimit të Planit të Integritetit, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 553, datë 30.09.2021 “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”.

Raporti jep informacion mbi zbatueshmërinë e masave dhe aktiviteteve, të realizueshmërisë së treguesve sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura, të parashikuara në Planin e Veprimit për realizimin objektivave të Planit të Integritetit nga bashkitë pjesëmarrëse në procesin e monitorimit.

Në përfundim të këtij raporti për periudhën janar - dhjetor 2024, bazuar në të dhënat e raportuara dhe analizën e kryer rezulton se:

- Strukturat e bashkive kanë vijuar punën për zbatimin e Planit të Integritetit;
- Strukturat e bashkive kanë dëshmuar vazhdimësi, përpjekje dhe vullnet për të zbatuar masat dhe për të realizuar aktivitetet, në përputhje me objektivat e parashikuara në Planin e Veprimit, duke shfrytëzuar kapacitetet dhe burimet njerëzore në dispozicion;
- Bashkitë kanë vijuar me përmirësimin e kuadrit rregullator dhe forcimin e etikës institucionale;
- Kanë ndërmarrë masa për trajnimin e stafit, vlerësimin e performancës, përmirësimin e përshkrimeve të punës dhe proceset e rekrutimit;
- Kanë përmirësuar mekanizmat e arkivimit dhe auditimit të brendshëm, si dhe kanë ndërtuar instrumente për sinjalizimin dhe mbrojtjen;
- Janë shënuar përmirësime të dukshme në transparencën proaktive, veçanërisht përmes përditësimit të faqeve zyrtare, publikimit të dokumenteve strategjike, informacionit financiar dhe akteve rregullatore;

VII. Hapat e radhës:

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën janar – dhjetor 2024, bazuar në gjetjet, të dhënat analitike që strukturat e bashkive kanë raportuar, si dhe analizës së kryer, rekomandohet të ndërmerren hapat si më poshtë:

Në përmbushje të objektivave të planifikuara në Planet e Integritetit duhet të vijojë puna për:

Objektivi 1: “Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe forcimi i etikës institucionale”

- Organizimi i trajnimeve mbi kuadrin ligjor dhe mekanizmat ligjorë për forcimin e etikës institucionale, duke përfshirë ligjin për të drejtën e informimit, ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ligjin për barazinë gjinore.
- Trajnimin e punonjësve mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen ligjore të sinjalizuesve;

Objektivi 2: Rritja e integritetit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;

- Marrja e masave për trajnimin e stafit në vlerësimin e performancës, përmirësimin e përshkrimeve të punës dhe për proceset e rekrutimit, duke nxitur meritokracinë dhe profesionalizmin, veçanërisht në sektorët me risk më të lartë si financat dhe menaxhimi i shërbimeve;
- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve që merren me procedurat e Prokurimit Publik. Angazhimin e specialistëve të fushës për objekte të prokurimit të cilat kërkojnë njohje të thelluar për shkak të natyrës specifike;
- Të sigurohet trajnimi i vazhdueshëm i koordinatorëve të integritetit;

Objektivi 3: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;

- Garantimi i vazhdueshëm që informacioni publik të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i përditësuar për qytetarët, për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë në veprimtarinë e qeverisjes vendore;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut në mënyrë të vazhdueshme përmes fushatave sensibilizuese mbi rreziqet e korrupsionit dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, si një mjet kyç për ndërtimin e një kulture të përgjegjshme dhe të integruar në shoqëri;
- Marrja e masave për përmirësimin e menaxhimit të territorit dhe të pronave publike, duke siguruar mbështetje buxhetore për realizimin e masave të planifikuara në këtë drejtim;
- Përforcimi i mekanizmave të monitorimit të brendshëm dhe sigurimi i raportimit periodik për zbatimin e Planit të Integritetit.

Shtojca 1: Shkalla e zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit

Nr	Bashkia	Nr. VKB	Data miratimit	Statusi aktual i raportit të monitorimit	Masa në total 2024 Janar-Dhjetor	Masa të realizuara plotësisht	Masa në proces realizimi	Masa të përcaktuara	Masa të realizuara plotësisht në %	Masa në proces realizimi në %	Masa të përcaktuara në %
1	Berat	9	02.03.2022	Hartuar	32	21	3	8	65%	10%	25%
2	Bulqizë	300	01.02.2022	Hartuar	33	19	10	4	58%	30%	12%
3	Durrës	127	28.10.2021	Hartuar	18	10	5	3	55%	28%	17%
4	Has	44	29.06.2022	Hartuar	13	8	4	1	61%	33%	6%
5	Himarë	28	27.05.2022	Hartuar	21	14	3	4	66%	15%	24%
6	Kavajë	52	24.05.2022	Hartuar	9	5	2	2	55%	23%	19%
7	Kukës	35	31.05.2022	Hartuar	33	17	14	2	52%	42%	6%
8	Lezhë	32	04.04.2022	Hartuar	5	3	2	0	60%	40%	0%
9	Librazhd	109	30.11.2023	Hartuar	69	40	19	10	58%	27%	14%
10	Lushnjë	87	27.10.2023	Hartuar	82	53	14	15	65%	17%	18%
11	Maliq	54	31.05.2022	Hartuar	22	11	4	7	50%	18%	32%
12	Patos	52	31.08.2023	Hartuar	31	19	4	8	61%	13%	26%
13	Pogradec	18	18.02.2022	Hartuar	11	7	3	1	63%	27%	10%
14	Pukë	33	03.03.2022	Hartuar	24	12	7	5	50%	29%	21%
15	Roskove	4	27.01.2023	Hartuar	22	15	4	3	68%	18%	14%
16	Shijak	20	07.06.2022	Hartuar	31	18	10	3	58%	32%	10%
17	Tiranë	35	06.04.2022	Hartuar	10	6	3	1	60%	30%	10%
Total masa					466	278	111	77	59 %	24%	17%

